

SERVETE DERGUTI

RRETH VLERAVE TË “FJALORTHIT TË RI” TË NIKOLLË GAZULLIT

U deshën thuajse pesë dekada që çdo punë e bërë në lëmin e shkencës dhe të kulturës nga shumë autorë e studiues të vlerësohej ashtu siç duhej. Dhe pikërisht, filloi ribotimi i veprave me shumë vlera për gjuhësinë shqiptare, të cilat deri më atë kohë ishin ndaluar të ribotoheshin. Një prej tyre është edhe “Fjalorthi i ri” i Nikollë Gazullit (1941).

Nikollë Gazulli mbledhi me shumë mundime leksikun e pasur të zonave të Shkodrës, Malësisë së Madhe, Ulqinit, Rrjollit, Dajç e gjetkë, me qëllimin që të mbledhte fjalë të rralla në veri të vendit, të cilat po pësonin fatin e gjuhës *Latine*¹, siç e thekson edhe vetë autori i fjalorthit.

Gjatë punës shteruese dhe të vështirë në terren, Gazulli mbledhte fjalë dhe ia dërgonte profesor Joklit për shqyrtim, të cilat do ta ndihmonin edhe profesorin në punën e tij kërkimore. Të gjitha këto mbledhje që dërgonte Gazulli, i shërbenin edhe Profesor Joklit për hartimin e “Fjalorit Etimologjik të Shqipes”.

Këtë korrespondencë, me letrat personale të Gazullit dhe me vjeljet e bëra në terren, mundësuar nga Biblioteka Kombëtare e Vjenës, e kemi paraqitur të plotë në punimin e mikrotezës, për mbrojtjen e Masterit Shkencor pranë QSA.

Gazulli analizoi për shumë vite me rrallë me mijëra fjalë të rralla, shprehje frazeologjike, toponime, antroponime etj. të cilat i mbledhi në një fjalorth.

Me ndihmën e intelektualit Karl Gurakuqi, drejtues i Ministrisë së Arsimit të asaj kohe, u botua “Fjalorthi i ri” i Nikollë Gazullit, me nëntitull (Fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipërisë), në kolanën “Visare të Kombit”, në vitin 1941 si vëllimi i XI i kësaj serie. Fjalorthi i Gazullit ishte i pari fjalor leksikor krahinor në të gjithë vendin për atë kohë. Më pas, në botimin e XII të saj, Ministria e Arsimit botoi edhe “Fjalorthin e ri” të Pano Tases, po në kolanën “Visare të Kombit”, botimi i XII, fjalorth i pa përfunduar, të cilët do të ndihmonin shumë leksikologjinë Shqiptare në hartimin e “Fjalorit të Gjuhës Shqipes” të vitit 1954.

Me ardhjen e sistemit komunist në Shqipëri, Gazulli u pushkatua pa u gjykuar në vitin 1946.

Por, ndër njerëzit më me zë dhe profesorët më të shquar e më të përkushtuar të shkencës së gjuhësisë Shqiptare si Aleksandër Xhuvani e Eqrem Çabej, do ta vlerësonin punën me shumë vlera të rralla të leksikut të mbledhur në fjalorth. Prof. Aleksandër Xhuvani, në njërën nga gazetatat prestigjioze të kohës, gazetën “Tomori”, përcakton se: “*Ky fjalorth i punuem me kujdes, ka ma se pesë mijë fjalë*

¹ N. Gazulli, *Fjalori i ri (Fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipërisë)*, Parathënie, f. 5.

dhe asht interesant për landen gjuhësore që ka mbrenda e që do të bahet objekt studimesh shumënduersh nga ana e linguistëve tanë e të huej”².

Gazulli mendonte për njehsimin e shqipes.

Hartimin e fjalorit të përbashkët të shqipes, ai e quante të mundshëm e të realizueshëm vetëm atëherë kur, në të gjitha trevat të ishte grumbulluar e studiuar e gjithë lënda leksikore e gjuhësore e shqipes, ku leksiku i shqipes të shihej si një pasuri mbarë kombëtare dhe të studiohej jashtë çdo paragjykimi dialektor.

• **Po, cila ishte risia që solli Gazulli me fjalorthin e tij në gjuhësinë e shkruar shqipe?**

Vlera e “Fjalorthit të ri” nuk qëndron vetëm në numrin e konsiderueshëm, me rreth pesë mijë fjalë, të fjalëve të thjeshta, kompozitave, shprehjeve frazeologjike, fjalëve nga fusha e botanikës, onomastika e toponomastika, por edhe në formimin e ndajshesave.

Syzimi mbi para-e mbrapashtesat në gjuhën shqipe ishte një punë sa e vështirë aq edhe e bukur e shumë me vlerë. Ata do të ndihmonin në krijimin e fjalëve të reja të shqipes të cilat do ti shtonin larmishmërinë gjuhës së folur dhe të shkruar.

Nga faqja 17 – 41, në fjalor gjejmë një numër tejet të lartë mjetesesh fjalëformuese me të cilat janë formuar një numër i madh fjalësh me prejardhje.

Me rend alfabetik, ai pasqyron 69 parashtesa fjalëformuese si: **A-:** qi difton largsi p.sh. *aty (këtu), a-ta (kë-ta)*; **B-:** *brumbullak (rrumbullak)*; **Ç-:** *ç-gërmue, ç-mekë, ç-mbushë, ç-rrethue*; **Kala-:** *kala-hum, kala-dredh*; **M-Mb-:** *mb-rrakullue, mb-rrutë, m-bollungë, m-brijáza, m-bríjuem*; **Mbë-:** *mbë-rrolët, mbë-shênjue, mbë-shtetsë, mbë-zuçkë, mbë-zâ*; **Ndën-nën;** *ndën-kambcën, ndën-tashëm, nën-kambcë*; **Ndër-:** *ndër-klisë, ndër-mendë, ndër-shejcë*; **Pa-:** *pa-ânat, pa-ândëshëm, pa-atillë, pa-dashtun*; **Për-:** *për-bûjtë, për-buzët, për-ftue etj.*;

dhe 153 prapashtesa fjalëformuese, si: **Ac-:** *firik-ác, kop-ác*; **Aç-ë-:** *kungull-aç, lug-ác, pjek-ác, rud-ác*; **An-:** *cur-an, kafk-an, shkret-an*; **Anë-:** *dërk-ânë, kat-ânë*; **Çë-:** *fill-çë, Ër-:* *bung-ër*; **Ërr-:** *bund-ërr*; **Esë-:** *ëmn-esë, germ-esë, etj.*; **si dhe disa shndërrime ndërzanesh,** si: **C-:** *Vuc (o Vukë), Uc (o Ujkë)*; **-Ç-:** *zgorç (zguer), guriç (guri)* ³siç i emërton autori.

Këto mjete fjalëformuese do të merreshin në studim nga Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani dhe Prof. Eqrem Çabej. Në parathënien e studimit mbi “Prapashtesat e gjuhës shqipe” (1962), autorët do të theksonin: “*Kemi konstatuar gjithashtu pasqyrën e prapashtesave që ka në hyrje të tij Fjalorthi i ri i N. Gazullit (1942), një punim dorëshkrim...*”⁴

- **Një vend të veçantë në fjalor zënë edhe fjalët me përbërje**

Në fjalor gjejmë një numër të konsiderueshëm kompozitash ekzocentrike-mbiemërore, të cilat paraqiten si kompozita determinative-përcaktuese, ku disa prej tyre nuk janë shveshur nga zanorja fundore dhe si kompozita dëshirore.

² A. Xhuvani, *Nji Fjalorth i Ri*, “Tomori”, Tiranë, 1941, nr. 308, f. 3.

³ N. Gazulli, *Fjalorth i Ri (Fjalë të rralla të përdorura në Veri të Shqipnis)*, 1941, f. 17.

⁴ A. Xhuvani, E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962, f. 3.

Rreth vlerave të *Fjalorthit të ri* të Nikollë Gazullit

1. Kompozita ekzocentrike përcaktuese (determinative), disa prej tyre nuk janë zhveshur nga zanorja fundore e cila hyn në komponentët e parë në kompozim si:

- ashkëkuqe** – që e ka ashkën të kuqe.
- ballafyçkë** – që e ka ballin të fryrë e të nxirë nga të vrarët.
- bjerraditas** – që e çon kot ditën.
- bollapjeshkë** – që është e fortë dhe e bukur si pjeshka.
- buzëvjerrë** – që var buzët.
- dorëmirë** – që i prihet mbarë shkrimi e punimet e tjera me dorë.
- dorëlehtë** – që i ecën puna.
- dorërrudhët** – që është i shtrënguar, koprrac.
- dhambëhekurt** – që s'xën, me dhambë hekuri.
- ferrëbardhë** – që e ka lulen në të kuqlemë në të brutët.
- ferrëkambëpatë** – që shpejton me bi – mandaferra.
- grykëhollë** – që e ka grykën e hollë, për antonomazin, pushkën.
- gurëgrihëç** – guri prej të cilit nxirren grihat.
- hijelehtë** – që është i dashtun në të prum me të tjerët.

2. Kompozita dëshirore e pronësore me përmbajtje semantike:

Autori jep ambivalencat e këtyre kompozitave edhe si dëshirore edhe si pronësore.

gurapesh-i: lojë me se sprovohet kush e hedh gurin ma larg. (këtë fjalë e gjejmë edhe sot në shprehjen popullore “nip e mbesë e gurapeshë”, që ju peshon fjala, si e rënda ashtu edhe e mira, sa forca dhe largësia në hedhjen e gurit).

ndeshëzi-zezë: ogurzi-zezë: ai që sjell e ndjell keq.

punërryeshëm-i, e: qi punon, a e i ecin punët rryeshëm.

kryesylidikë: për, njeri i pamend, me pak mend.

shkundadimën-i: për ditët e plakave në mbarim të Marsit e ndër të parat e Prillit, të ftohtit e mbramë të dimnit. (kjo fjalë zë vend edhe në shprehjen popullore, ku muajt i janë lutur njëri-tjetrit; “*Prill, Prill, o em vëlla, a m'i nep tri dit uha, ta ngrij plaken me çka ka se shkundadimën asht tashma*”, e cila paraqitet si një dëshirë e fundit e stinës së dimrit).

Profesor Androkli Kostallari, në punimin e tij shkencor: - Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhë shqipe”, ndër të tjera, si kompozitë të mirëfilltë, merr edhe fjalën nga fjalorthi i Gazullit: gjeth-thue-pulë⁵,

Ndërsa në: “Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese”, Prof. Kostallari sjell një sërë mbiemrash që përfaqësohen mjaft gjerë në fjalorthët e Nikollë Gazullit dhe të Pano Tases. Për kohën kur u botua ky shkrim ishte vërtetë një guximshmëri nga ana e autorit.

Nga e gjithë kjo llojshmëri njësi fjalësh, në fjalor nuk mungojnë edhe ndërtimet me përngjitje. Edhe pse autori paraqet një numër jo të vogël të pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës, na është dukur e udhës që të marrim si njësi të

⁵ A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe” 1, Tiranë, 1972, f. 95-104.

përngjitura një numër të vogël të tyre. Po paraqesim disa prej tyre: *afërmendësh* (*afër-mendësh*) “*mos fol afërmendësh*”, *neshtrasha*, (*ndesh-të-rasha*), *gjithëkah* (*gjithë-kah*), *ndërdyzash* (*ndër-dy-zash*) e *ndërdym*, “*jam ndërdyzash a me i a la a mos me i a la paret*”, *medigiasë* (*me-dy-giasë*), *kudo* (*ku-do*), *kendo* (*ken-do*), etj.

Fjalori përmban fjalë të përngjitura në llojin e kompozitës⁶, si: *afërmendësh*, *berrejshëm*, *buzdele*, *buzëvjerrë*, *dhambësutë*, *frysëkuqe*, *grukakuqi*, *kryeshtrëmbët*, *lubardhë*, *lulëkarthi*, *lulkuqi*, *lulshpërvjeltë*, *lulshterpë*, *mjekërrdhizë*, *mollakuqi*, *mundbjerrun*, *pulëbardhë*, *rrogazi-zezë*, *skjeplugë*, *sygjarpën*. *Sykau*, *shikakuqi*, *shprishalesh*, etj.

Cili ishte horizonti i dijeve të Gazullit?

Njohjet që kishte mbi gjuhët e huaja, si, gjermanisht, italisht, latinisht e sllavisht, njohuri mbi gjuhën frënge e turke, sanskritishten apo arabishten, e ndihmuan atë në paraqitjen konsekuente të fjalëve në fjalor. Ai i analizon fjalët e fjalorit duke bërë krahasimin e tyre edhe me gjuhët e tjera të cilat i njihte shumë mirë.

Me një rend të mirëfilltë alfabetik, Gazulli rreshton etimologjitë e mirëfillta, krahasimet dy apo trepalëshe, krahasimet me gjermanishten, italisht, latinisht, greqishten, sllavishten, turqishten e frëngjishten.

Fjalët në fjalor paraqesin më shumë se një përjasje me gjuhët e tjera evropiane, ato mund të krahasohen me dy, tri e më shumë gjegjëse në gjuhët e tjera, ku po pasqyrojmë disa shembuj.

• Nga përjasjet me gjermanishten sjell një numër të konsiderueshëm fjalësh, si:

ah i bardhë (M:M: SKLL) e ah i kuq: ai çahet mirë e drejtë, teret shpejt, e asht ma rnojc: ahi i kuq: *fagus silvatica*, **germ. Rotbuche**: me lëkurë të zeshkët, s'çahet drejt, me gëdhaj, kalbet ma shpejt.

domçik-u (M:M: Rr.) s. m. me luejtë domçik, cicmic (SHK: SP) **germ. Mühlespiel**

• Nga përjasjet me latinishten:

ânas i, -ja, (MM.) s. e adj. m. f. shms. ë, it. -e, t 1. banuer autokton; **lat indigena**. 2. fiset e gjetuna në vend prej ardhacakësh.

akull: (PL.) adj. **lat. integer**, **sine defectu**: dru akull, i ka mendët akull (SP: MM).

lulës-i, -e, ja (QL: PK) adj. **lulëz-i, -e, -ja**, i shëndritshëm, (M:M). **lat. lucidus**, it. lustrò (adj).

• Nga përjasjet me italishten:

âmë-a (MM) ka âmë vajguri, buka paska âmë të randë; âmë e mirë: shije, a; **ital. Sapore**.

Ani i dorës (Salçi, Ulqin) s. m. nëni i dorës: **ital. carpo**.

• Nga përjasjet me sanskritishten:

⁶ A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, po aty, f. 83.

ângërr-a (P.K) –a, t. S. m 1. Lëkurëz trupi qi mshehë ndonji mish a lang; grek. Hymen, **sanskrit. Syuman = lëkurëz, lidhcë**. 2. ângrra e mushknivet; lat. pleura. 3. ângrra e zorrvet; greq. peritonaion, germ. Bauchfell. 4. ângrra e bolevet; lat. scerra. 5. ângrra e dheut: koja, mysi, syprina e dheut.

• **Nga përqasjet me turqishten: -**

andaq-e (Uk. PK). adj. andaqe pune, mësimi: **turq, qefli**.

aktund-i (SP: D). s. m. rend, **kurâ (turq.)**: kur i erdh aktundi me shkue ushtâr.

• **Nga përqasjet me arabishten sjell: -**

allçënik-u (Km. PK) s. m: **realgar (arabisht)** një farë guri nyeje së rubinit qi në katund të Komanit gjindet edhe mbi dhe, në zjarm digjet; përdoret me shkrymbë varrët; germ. rote Arsenblande: mineral prej lidhjes surfullore me arsen.

• **Nga përqasjet me sllavishten sjell:**

lvorue (PK) v. akt. 1. Me hjekë lvoren, me qerue: e lvorova mollën. 2. V. pas. m'u lodh fort, lllomitë (**sllav. lomiti**), *jam lvorue trupit, jam lvorue trupit me punë*.

• **Nga përqasjet me greqishten sjell:**

doracak-e (SP. M:M.) adj. vegël, almise qi vjen përdorësh. 2. s. m. (libër) doracak; **grek. enchiridion**, it. manuale.

druejshëm (i, e, M:M) adj. i tëmërshëm; lat. terribilis; **grek. foberos**. Ishte të druejshëm m'u pa me sý.

• **Nga përqasjet me frëngjishten sjell:**

afçë-a (Rr. M:M) s. f. shpend i vogël me pendla të verdhemta: **frang. verdier**; it. verdone.

afërmendësh (M:M. afërmëç) adv. mos fol afërmendësh: mos fol nëpër të, dishka atypari, jo gja të njimëndtë. –Kjo pûnë âsht afërmendësh. **frang. a peu prés**, ital. press' a poco.

Veçanti në këtë fjalor, përbëjnë emrat botanikë e gjeografikë, si dhe disa të dhëna të tjera të etnolinguistikës për zonën e Veriut, ku zbulohet forca e gurrës popullore jo vetëm me leksik të përgjithshëm, por me mënyrën se si mund të shfrytëzohen mjetet gjuhësore të atij leksiku për emërtime të ndryshme.

Nëpërmjet këtij leksiku paraqitet edhe jeta e vështirë e malësorit. Vështirësitë që ka ai për ta përballuar jetën e egër të malit. Autori, në këtë fjalor sjell edhe një numër të konsiderueshëm emërtime sëmundjesh për njerëz e kafshë, por edhe emërtimet për barnat, me të cilat kurohen këto lloj sëmundjesh.

Emërtime sëmundjesh

brie-ja: - briesë-a, të brietë-it, dergjë qi brén mishin edhe ashtin; kulufiskë eshtënash...

errgjë-ja: - lëngatë, fëdigë, mundim në trup, *njeri me errgjë*, me lëngatë.

filosë: - dergja i a filosi mushkënit: me shtû filí.

koturác-i: - rufë e fortë kualësh, me koll e ktërrë; koll i keq; kitoraç, sakllagí kualësh.

lënzë-a: - dylbëz-a, lëngatë qi u del berrevet me dregca në turî, gojëz-a.

ligcinë-a: - ligëci-ja, të këputun shtati, të ramët e shtatit gardh.

majnue: - majnitë, mamitë, janë majnue berret, kursë berrit i **bâhentrût** uj; sh. rrebisë; të dy verbat diftojnë lëngatë të ndryshme në bagti. 1. rrepci jeton ndërshej brinash së berrevet, e u hynë në tru. 2. Koshëza jeton në lëkurë të korrozit të gjedhvet. 3. dhecku i zgrofit lëshon voet në koma të kalit, ky tue e lpim voen e perdin, e kjo shvillohet në lugth të tîj.

ndiellit: - hjektore, lëngatë qi vjen prej diellit, lëngatë trûsh.

përftajë-a: - çdo lëngatë qi i njetet fytit a hundvet; flamë-a, grip-i, rrufë-a, të ftofun.

plaze-ja: - lëngatë qi e mbytë shpejt bagtîn.

pulveshe-ja: - pulëveshe-ja, ajazma, t'ajun mbas veshit.

rrebnim-i: - të rrebisun-it, lëngatë të përftueme në bagti prej rrepcash.

rrebnu: - rrebisë, kûr bagtis s'imë i ngulet rrepci ndërshej brinash e i a biron, e bân me lëngue e së mbrami e mbytë.

rrebullâr-i: - rrebull-i, lëngatë qi u bjen fëmijvet në krye, u dalin mullâj e u dregësohet kryet, përftue prej kullimesh së trupit.

rrebulli-ja: - të kruem në krye shkaktue prej rrebulli; dëshir, gjakim i fortë.

rrpujë-a: - shikë shkaktue prej së djeguni, të djegunit e mishit qi forcohet.

skerc-i: - shqyptyrë, shkeptyrë, lëngatë bagtish s'îma, sî shita.

stërpi-ja: - lëngatë qi mbaron trupin e njeriut tue i thithë gjakun.

shapth-i: - lëngatë bagtish, aphta epizootica.

shitë-a: - lëngatë berresh e dhîsh, u pelset lëkura në dasë të thundravet e shkjepojnë, shkjeptyrë, skërc-i, majesil-i. 2- bâr shite, bimë *Polygonatum officinale*.

Emërtime që lidhen me bimësinë me efekte kuruese:

Këtë lloj bimësie e shohim si pjesë të pandashme të jetës së këtyre banorëve.

arrs-i: - arrës-i; barojë me gjeth si petroseli, del shkambijsh, përdoret si bër mjeksuer.

bar Shëngjergji: - 2- bâr gjinit, bar si vjollcë me lule të vogla fort e të verdhëme, 4- bari i të kuqit të madh. 8- bâr zemre, bimë qi rritet ndër bjeshkë të nalta 1500 metrash, e njehë këto lloje: *G. acaulis*, *G. amarella*, *G. asclepiadacea*, *G. campestris*, *G. lutea*, *G. pneumonanthe*, *G. verna*. Shqip përshihen me ëmnin *sanëz*, qi duen me thânë se *âsht* një svoglim i ëmnit *Gentiana* (Genthios, mbret ilyr).

buçi: - bar gjarpëni, barijt e shtypin të njomë me krypë e përzîe me raki u a kojnë bagëtivet qi i ká zân gjarpni, lule buçi.

hyshtër-a: - bîmë, sh. fyshnje, me fërkue të sëmundët.

idhëz-a: - bîmë si brengca, del buzë rugash e ndër livadhe, lulon kah vjeshta, e familjes së kompozitevet, lulen e ka në njeje të portokalit, e gjethin si *Calendula officinalis*, rritet nja 1/2 metri mbi tokë, *âsht* e idhët në të gjinuëm. (lloj bime, çaji, me shije e aromë si të tetraciklinës).

jërmsinë-a: - bîmë qi përdorin me hjek jelin.

kofilë-a: - bîmë, maja, lulja e kallmit, qi duen me thânë dliërë bagtin prej këlbazësh.

kúngull i egër: - bîmë me rrâjë sî kërtollë, fijet e rrâjës shkojnë gjatë, gjethet i ká të bërðhâmë, hypë në férra e shtrohet për tokë. Malsorët në prendvërë lbogurat e rrâjës së bimës u a përziejnë në gjollë berrevet (ditën e shë Gjergjit) psë kshtu thonë s'i merr dâmi. Rrâja e kungullit t'egër e përzieme me lyesa përdoret edhe me hjekë qirosën.

lulshpërvjeltë-a: - bîmë bjeshke, bar tâmbëlthi (sh. bar tâmbthi.)

lvére-ja: - lvére fiku, ...llapë qi u vëhet varrvet (plagëve).

makth-i: - makth i butë, makth i egër, (psë gjethi i kqyrun në rreze të dielli duket sî i shpuem prej pikavet të njëj voji erëkandëshëm qi përmban) (gjethi i bimës së makthit përdoret edhe sot në vend të fenolftaleinës, thëne në gjuhën popullore, bar teje.)

mendër-a: - për sherbelë-a; *mendër-bardhë*, një farë sherbele, *mendër e egër*.

mërtik-u: - bîmë, bâr ujthi, bâr mërtiku, një farë bari. (ilaçi)

pjepën i egër: - bastan i egër, bîmë; bogulat e tija të ngjoma a të pluhnueme si burrnót i përdorin me shëndoshë vërrëçin (sarallekun); langu i bogulavet bân me shpërthye për hundësh ndragun e mbledhun në trup; me shtrydh pjeprnin e egër, qet lang t'idhët qi shpërlân lugthin e bân me vjellë, me lang dalin farëzat.

rriollcë-a: - rmill, rmilli mali, me e këputë qet tâmbël të bardhë, qi âsht helm i fortë psë me nandë pika e çon njerín në deké; ka cilsinat e Kaktus të Meksikut, psë i helmatuemi në klláp kallëzon gjithëshka t'i pyetet, por kúr shëndoshet, s'i bjen në mend për shka foli. Djerë në 5 pika i përdorin me shlrue barkun.

tamblagjak-u: - bîmë, bâr me lang si jodi, të cilin mund t'a zâvendsojmë në të prême.

Shprehjet popullore kanë veçoritë e tyre sipas ndërtimit sintagmatik në fjalor.

Të gjitha këto veçori strukturore tregojnë pasurinë dhe larmishmërinë e njësive frazeologjike të "Fjalorit të ri" të Nikollë Gazullit. Por, nëse këto njësi frazeologjike, shprehje popullore i shohim në këndvështrimin e tyre ndërtimor apo sintagmatik, do të dallojmë struktura interesante të cilat do të përfshihen në dy grupe:

a. Ndërtime të plota ose përdorime fjalish, si:

S'kishte mend as sá me i lagë grëzi kambët në trû të tija.

Mos e harbo sýnin tepër qi me t'u dukë një send për një tjetër.

Njatë qi han bukën e përmbysë kupën ka me e ngrí Zoti bibirek, etj.

Sipas ndërtimit, fjalitë janë të përbëra, nëpërmjet të cilave është e përcaktuar edhe natyra e shprehjeve si: përshëndetje, urime, mallkime, lutje, ngushëllime etj.

Shkado qi të thotë goja e njeriut s'e kumbë dijen! (sado i mençur të jetë njeriu s'e mund dijen).

Në kohën me lezmue po duhet me vajtue!

Dikúj i han mini pallën dikuj i han daci arën!

Shka nduell zogla prûni véra!

Loja e ksulvet âsht betore e kanga e tyne gaztore.

*Bjen një dhî e strokë një mijë.
Mos e harbo sýnin tepër qî me t'u dukë një send për një tjetër.
Njatë qî han bukën e përmbys kupën ka me e ngrî Zoti bibirek.*

*Mendo keq e thaju mendo mirë e maju.
Njatë qî han bukën e përmbys kupën ka me e ngrî Zoti bibirek.
Qep një pëllambë e shkep një pash.*

M'u endë e m'u shendë – shkon e vjen rrotull, me shetitë teposhtë e përperjetë, etj.

b. Ndërtime të paplota, të tkurrura, të cilat kanë përfunduar në ndërtime nominative togfjalëshore si:

*Motis së jetës.
Brumi i njëj mielli.
Një bathë e një kokërr.
Zëmër qofe.
Torrla e ditës së zezë.
Gjâja e keqe, etj.*

Cila është rëndësia që pati Fjalori i Gazullit për gjuhësinë shqiptare dhe vlera e rrallë që ka sot.

Një pjesë e mirë e fjalëve të “Fjalorit të Gjuhës Shqipe” të viti 1954, Botimi Anastatik, janë të mbështetura bindshëm në fjalorthin e Gazullit si në një taban fort të çmuar lëndor e shkencor.

Nga shkronjë –**A**, në fjalorin e1954, janë marrë 28 fjalë titull nga fjalori i Gazullit.

Edhe nga shkronja –**B**, janë marrë 78 fjalë titull. Nga shkronja –**C**, janë marrë 25 fjalë titull. Nga shkronjë – **Ç**, janë marrë 16 fjalë titull. Nga shkronja –**D**, janë marrë 31 fjalë titull, por në fjalorin e 1954 paraqiten këto ndryshime fjalësh të cilat kanë të njëjtin kuptim: **-dimërore**, për **-dimnake**; **-ditoj**, për **-me ditue**. Nga shkronja –**Dh**, janë marrë 5 fjalë titull. Nga shkronja –**E**, janë marrë 11 fjalë titull. Nga shkronja – **F**, janë marrë 42 fjalë titull. Nga shkronja – **G**, janë marrë 52 fjalë titull. Nga shkronja – **Gj**, janë marrë 15 fjalë titull. Nga shkronja –**H**, janë marrë 37 fjalë titull. Nga shkronja – **I**, janë marrë 13 fjalë titull. Nga shkronja –**J**, janë marrë 7 fjalë titull. Nga shkronja –**K**, janë marrë 163 fjalë titull. Nga shkronja –**L**, janë marrë 69 fjalë titull. Nga shkronja – **Ll**, janë marrë 6 fjalë titull. Nga shkronja –**M**, janë marrë 108 fjalë titull. Nga shkronja –**N**, janë marrë 43 fjalë titull. Nga shkronja –**Nj**, janë marrë 7 fjalë titull. Nga shkronja –**O**, janë marrë 2 fjalë titull. Nga shkronja –**P**, janë marrë 61 fjalë titull. Nga shkronja –**Q**, janë marrë 27 fjalë titull. Nga shkronja –**R**, janë marrë 11 fjalë titull. Nga shkronja –**Rr**, janë marrë 42 fjalë titull. Nga shkronja –**S**, janë marrë 77 fjalë titull. Nga shkronja –**Sh**, janë marrë 145 fjalë titull. Nga shkronja –**T**, janë marrë 58 fjalë titull. Nga shkronja – **Th**, janë marrë 53 fjalë titull. Nga shkronja –**U**, janë marrë 19 fjalë titull. Nga shkronja –**V**, janë marrë 78 fjalë titull. Nga shkronja –**Z**, janë marrë 44 fjalë titull. Nga shkronja –**Zh**, janë marrë 21 fjalë titull. Nga shkronjat –**Y**, **-X**, **-Xh** nuk është marrë asnjë fjalë titull nga fjalori i Gazullit.

Rreth vlerave të *Fjalorthit të ri* të Nikollë Gazullit

Profesori i mirënjohur Aleksandër Xhuvani, do ta emëronte Gazullin në mes të tjerave:

“...më i dijtshmi që ka pasë ndonjiherë Biblioteka Françeskane”.

Përfundime

Edhe pse “Fjalorthi i ri” i Nikollë Gazulli mbart disa mangësi të kushtëzimeve të kohës, të traditës dialektore leksikografike e leksikologjike, mangësi që kanë ardhur jo nga mungesa e profesionalizmit të hartuesit të fjalorthit, por nga faktorë të ndryshëm, shpërfaqet një lëndë e vlerësueshme leksikologjike, dialektologjike, etnolinguistike, sociolinguistike, historike etj.

- Shumë prej fjalëve të fjalorëve janë ngritur në nivel termash teknikë, duke u përfshirë në fjalorët terminologjikë.

- Ka një numër të konsiderueshëm fjalësh, si fjalë-titull edhe fjalë që gjenden në shpjegimin e tyre që duhen vlerësuar duke i futur në përdorim si fjalë, ose për të zëvendësuar fjalë të huaja, apo si emërtime të nuancave, të detajeve e te pjesëve, sepse ndjehen fjalë shqipe të motivuara ose të ndërtuara sipas mënyrave fjalëformuese të shqipes. Koha ka treguar se shumë fjalë që ndjeheshin si dialektore, duke hyrë nëpërmjet fjalorëve në gjuhën e shkrimit, u ngritën në normë dhe u bënë pjesë e fondit aktiv të gjuhës.

